

SHPALLJE PËR VEND TË LIRË PUNE

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Bashkia e Elbasan shpall procedurat e konkurimit për vendin e lirë të punës :

2 Agjent Tatimor, Sektori i Terrenit, Tregut dhe Menaxhimit të parkimit në Drejtorinë e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- 1) Të jetë shtetas shqiptar;
- 2) Të ketë arsim të mesëm ose të lartë
- 3) Të ketë cilësi të larta morale e qytetare;
- 4) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar;
- 5) Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- 1) Kërkesë për aplikim (me shkrim dore);
- 2) Curriculum Vitae
- 3) Fotokopje e Kartës së Identitetit;
- 4) Çertifikatë e përbërjes familjare;
- 5) Fotokopje e diplomës së shkollës dhe lista e notave e noterizuar;
- 6) Fotokopje e librezës së punës.
- 7) Raport mjeko-ligjor;
- 8) Vërtetim i gjendjes Gjyqësore;
- 9) Dy fotografi (2.5 x 3.5 cm)

Adresa Rr.Vasil Llapushi, pranë Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional, Godina H, Elbasan.

Dorëzimi i dokumentave dorazi pranë Bashkisë Elbasan në Drejtorinë e Administratës dhe Burimeve Njerëzore duhet të bëhet brenda datës: 31.08.2021

KUJDES: KJO SHPALLJE DO TE PUBLIKOHET NE STENDAT E INFORMIMIT QYETAR DHE NE FAQEN ZYRTARE TE WEB TE BASHKISE ELBASAN.